



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

**VENDIM
Nr. 300, Datë 19.10.2023**

**MBI
KËRKESËN E SHOQËRISË “WENERG” SH.A. PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA
ERE PËR NDRYSHIMIN E AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT E SAJ**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 7 dhe 9, pikat 4 dhe 5, dhe nenit 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1960/8 prot., datë 12.10.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “WEnerg” sh.a. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “WEnerg” sh.a. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 51, datë 05.07.2010, si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 137, datë 08.10.2012.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1960 prot., datë 24.07.2023 dhe nr. 1960/1 prot., datë 03.08.2023, shoqëria paraqiti kërkesën dhe dokumentacionin për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat e kësaj shoqërie, për transferimin (nëpërmjet shitjes) të 51 % të aksioneve të zotëruara nga “CN’AIR” te aksionari tjetër i shoqërisë “YLLIAD”, i cili zotëron 49 % të aksioneve dhe me këtë transferim bëhet aksionar i vetëm, me 100 % të aksioneve.
- Shoqëria ka informuar se shitja e aksioneve që shoqëria CN’AIR zotëron në kapitalin e shoqërisë “WEnerg” sh.a., vjen si rrjedhojë e një riorientimi strategjik të shoqërisë CN’AIR, e cila do të fokusojë aktivitetin e saj në tregje të tjera. Në këto rrethana, aksionarët e shoqërive “CN’AIR” dhe “YLLIAD” kanë vendosur të krijojnë kushtet e duhura për kalimin

e aksioneve dhe garantimin e aktivitetit të shoqërisë “WEnerg”, në përputhje të plotë me detyrimet e kësaj të fundit për Licencën e Prodhimit, Licencën e Tregtimit dhe detyrimeve të saj koncesionare. Gjithashtu aksionari i shoqërisë “YLLIAD” ka shprehur dëshirën për marrjen e plotë të kontrollit të “WEnerg”, në cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë me synim optimizimin e mëtejshëm të aktivitetit të prodhimit.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, me shkresën e ERE-s nr. 1960/2 prot., datë 16.08.2023, iu evidentua shoqërisë dhe dokumentacioni i munguar për këtë aplikim. Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1960/3 prot., datë 28.08.2023, ka kërkuar më shumë kohë në dispozicion për plotësimin e këtij dokumentacioni, ndërsa me shkresat me nr. 1960/5 prot., datë 12.09.2023 dhe nr. 1960/7 prot., datë 06.10.2023 shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues për këtë aplikim.
- Shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 7, pika 1 dhe 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”.
- Shoqëria “WEnerg” sh.a. nuk ka detyrime të pashlyera ndaj ERE-s për sa i përket pagesave të rregullimit.
- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë “WEnerg” sh.a. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë “WEnerg” sh.a., për transferimin (nëpërmjet shitjes) të 51 % të aksioneve të zotëruara nga aksionari i shoqërisë “CN’AIR” te aksionari tjetër i shoqërisë “YLLIAD”, i cili zotëron 49 % të aksioneve të shoqërisë “WEnerg”sh.a.
2. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat e shoqërisë “WEnerg” sh.a. nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “WEnerg” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.